



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** 1.1 Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

1.2 Zhvillimi i seancës dëgjimore me kandidatin z. {...}, që konkurren për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

1.3 Vijimi i procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit përfundimtar të kandidatit, z. {...}, që konkurren për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

***1. Naureda Llagami***

***(kryetare)***

<sup>1</sup> Nën-pika e parë dhe e dytë e kësaj çështjeje u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përfundoi në orën 11:04. Nënçështja e tretë dhe të gjitha çështjet e tjera pjesë e rendit të ditës u zhvilluan nëpërmjet platformës online.

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| 2. <i>Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| 4. <i>Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| 5. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| 6. <i>Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| 7. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| 8. <i>Marçela Shehu</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| 9. <i>Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)</i>         |

**Shënim:** Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, për shkak të heqjes dorë më herët në marrjen pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.*
7. *Staf administrativ i KLGJ-së.*
8. *{...}, kandidat për gjyqtar në Gjykatën e Lartë (prezent vetëm gjatë procesit të intervistimit.)*

## **RENDI I DITËS:**

1.1 Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

1.2 Zhvillimi i seancës dëgjimore me kandidatin z. {...}, që konkurren për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

1.3 Vijimi i procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit përfundimtar të kandidatit, z. {...}, që konkurren për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Naureda Llagami:*** Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 25.03.2022. Në rendin e ditës sot kemi 8 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit.

Çështja më e rëndësishme e rendit të ditës sot është shqyrtimi i projektvendimit Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit paraprak të kandidatit, si dhe të listës së kandidatëve më të mirë që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; Për vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatit z. {...}.

Paraprakisht dëshiroj që t’ju informoj, që të pranishëm në shqyrtimin e kësaj çështjeje janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përveç z. Alban Toro dhe znj. Fatmira Luli, të cilët kanë parashtruar kërkesë për heqje dorë nga marrja pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje (kërkesa të cilat janë miratuar me vendimet përkatëse).

Pa humbur kohë fillojmë me relatimin e projekt-aktit të parë.

Fjalën ia jap relatorit, zotit Hallunaj.

***Dritan Hallunaj:*** Faleminderit, Kryetare!

Në vijim të procedurave për kandidimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, kemi përgatitur si Komision informacionin, të cilin do vijoj ta prezantoj, si dhe relacionin për sa i përket procedurave të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit.

Po filloj me informacionin për të informuar Këshillin, pra, mbi procesin e kandidimit për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

drejtës civile, shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

“Me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 3/c dhe 5, të nenit 48 dhe nenin 49, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në pikën 1, të nenit 31, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile”.

Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të përcaktuar në vendimin si më lart, kanë shprehur interes dhe kanë aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionin e shpallur në fushën e të drejtës civile kandidatët si vijon:

1. Znj. {...}; 2. Z. {...}; 3. Znj. {...}; 4. Z. {...}; 5. Z. {...}; 6. Znj. {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, me vendimin nr.182, datë 02.10.2019, bazuar në nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e tij nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, që kanë aplikuar për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.172, datë 11.09.2019” (pika 1). Po me këtë vendim (pika 2), pas shortit të hedhur, është caktuar relatori përkatës për procedurat e verifikimit për kandidatin {...}. Dhe me anë të pikës 3, është përcaktuar se: “Për kandidatët znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar për pozicionet e shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.108, nr.109 dhe nr.110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.172, datë 11.09.2019.”

Sipas pikës 4, është vendosur: “Mosfillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të

shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, për kandidaten znj. {...}, në kushtet e tërheqjes së saj nga kandidimi më datë 30.09.2019.”

Procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Lartë kanë përfunduar me vendim të formës së prerë për të gjithë kandidatët, konkretisht si vijon:

Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të “përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”, përcaktuar në nenin 136, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

a) Me vendimin nr.283, datë 10.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Skualifikimin e kandidates jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me..., ndër të tjera, dhe vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

{...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të “nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

a) Me vendimin nr.228, datë 22.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me..., ndër të tjera dhe Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me vendimin nr.258, datë 17.12.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë”.

Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të “moskalimit të procesit të verifikimit të pasurisë”, përcaktuar në nenin 49, pika 5 në

lidhje me nenin 32 pika 4 shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë:

a) Me vendimin nr.41, datë 23.01.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Skualifikimin e kandidates jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet..., ndër të tjera dhe vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; b) Mbi ankimin gjyqësor të kandidatit, me vendimin e datës 07.03.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: “Rrëzimin e padisë”.

Z. {...} është kualifikuar në procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit. Për këtë:

a) Me vendimin nr.255, datë 12.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimet..., ndër të tjera dhe Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

Z.{...} është kualifikuar në procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit. Për këtë:

a) Me vendimin nr.560, datë 13.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z.{...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; b) Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim gjyqësor.

Për znj. {...}, me vendimin nr.182, datë 02.10.2019 është vendosur mosfillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, në kushtet e tërheqjes së saj nga kandidimi më datë 30.09.2019.

Nga 6 (gjashtë) kandidatë që kanë konkurruar për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dy prej tyre, konkretisht z. {...} dhe z. {...}, janë kualifikuar për të vijuar procedurën e përzgjedhjes për emërim.

Bazuar në Kreun V, Seksioni A, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së

kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, fillon me vendim të Këshillit jo më vonë se 7 ditë, nga vendimi i parë përfundimtar i Këshillit për kualifikimin për emërim të një kandidati për atë pozicion të lirë. Mbi këtë bazë, me vendimin nr.262, datë 13.11.2019, “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1.Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2.Caktimin e z. {...} si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”.

Vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit z. {...} i marrë në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është i vlefshëm edhe për procedurën e përzgjedhjes për emërim për pozicionin e lire të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rezulton se për kandidatin z. {...}, me vendimin nr.111, datë 27.02.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.”

Si e tillë, kandidati i vetëm i mbetur në garë për pozicionin e shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019 është z. {...}.

Në kushtet kur vetëm një prej kandidatëve është kualifikuar në fazën e parë, pra atë të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, procedura e përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), ka vijuar vetëm për këtë kandidat, konkretisht z. {...}.

Për procedurën e përzgjedhjes për emërim të ndjekur për kandidatin e vetëm z.{...} është përgatitur Relacioni “Për procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatin për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, z.{...}”, si dhe Projektvendimi Paraprak “Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit z. {...}”, në zbatim të kërkesave vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, si dhe në përputhje me kërkesat e vendimit të tij nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

Tani po vijoj me relacionin “Mbi procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatin për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, z.{...}”.

Me vendimin nr.172, datë 11.9.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 3/c dhe 5, të nenit 48 dhe nenin 49, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe në pikën 1, të nenit 31, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.

1. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për pozicionin e lirë të shpallur përmes vendimit me sipër, ka aplikuar për të marrë pjesë edhe z.{...}.

Me vendimin nr.182, datë 02.10.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e tij nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.



2. Caktimin e relatorit...”, si dhe më tej kanë vijuar të gjitha procedurat të cilat nuk po i citoj. Janë të parashtruara të gjitha në relacion. Pra janë të gjitha procedurat se si është njoftuar kandidati, afatet, çfarë veprimesh janë kryer nga ana e Këshillit.

Po vijoj me pjesën e aktit të vlerësimit dhe pikëzimit.

Me fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 18.11.2020, bazuar në parashikimet e vendimit nr.102/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes dhe për relatorin, duke iu bërë e ditur e drejta për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e njoftimit. Gjithashtu, kandidatit iu bë i ditur detyrimi për dorëzimin në zyrën e posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit, të listës së dokumenteve, në origjinal ose të vërtetuar sipas ligjit, që përfshinte:

- a) jetëshkrimin e përditësuar me të dhënat deri në kohën e dorëzimit, të hartuar sipas formatit bashkëlidhur njoftimit;
- b) dokumentin që përshkruan motivimin e kandidimit dhe objektivat nëse emërohet;
- c) pesë dokumente profesionale...;
- ç) dokumente të tjerë që shërbenin për vlerësim...;
- d) deklarimin, nëse zotëron, njohuri në gjuhë të huaja, të shoqëruar, nëse i disponon, me dokumente përkatëse...

Kandidati mori dijeni dhe brenda afatit nuk paraqiti ndonjë kërkesë për përjashtimin e relatorit dhe/ose të ndonjë anëtari tjetër, si dhe ka dorëzuar pranë Këshillit, brenda afatit shtatëditor dokumentet e nevojshme sipas përcaktimeve të vendimit nr.102/2019, protokolluar rregullisht me nr. {...} prot., datë 23.11.2020.

Dokumente të depozituara pranë Këshillit nga kandidati z.{...} janë si vijon:

- I. Jetëshkrim i përditësuar.
- II. Platformë e paraqitjes së motiveve dhe objektivave të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

III. Dokumente ligjore:

Ankimi kundër vendimit nr.{...}, datë 13.06.2018, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. {...}; Ankimi kundër vendimit nr.{...}, datë 03.08.2018, të KPK-së, për

subjektin e rivlerësimit z. {...}; Ankim kundër subjektit z. {...}; Ankimi kundër vendimit nr.112, për subjektin z. {...}; Ankimi kundër vendimit nr.{...}, për subjektin z. {...}; Ankim kundër vendimit nr.{...} për subjektin znj. {...}; Ankim kundër vendimit nr.{...} për subjektin znj. {...}; Ankim kundër vendimit nr.{...} për subjektin e rivlerësimit z. {...}; Ankim kundër vendimit nr.{...} për subjektin znj. {...}; Ankim kundër vendimit nr.{...} për subjektin znj. {...}; dhe në vijim për subjektet z. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}; etj.

IV. Artikuj shkencorë në fushën e së drejtës, të botuar në revista shkencore dhe profesionale, të cilat janë të gjitha të specifikuar në relacion dhe për efekt kohe nuk po i lexoj.

V. Artikuj në Konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat ndodhen të gjitha të listuara në materialin që ju keni përpara.

Bazuar në shkronjë “b”, pika 8, Seksioni A, Kreu V, të vendimit nr.102/2019, lista e dokumenteve të paraqitura nga kandidati për efekt vlerësimi profesional u publikua rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 25.02.2021.

Më datë 02.12.2020 dhe 07.12.2020, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, u vlerësua e nevojshme sqarimi dhe plotësimi i tij, nga kandidati, për disa momente, duke u njoftuar për këtë kandidati, në rrugë elektronike.

Më datë 03.12.2020 dhe 09.12.2020, brenda afatit pesëditor të caktuar, kandidati depozitoi pranë Këshillit sqarimet e tij, të cilat ju i keni të parashtruara në materialin që keni.

Përshkrimi i fakteve dhe dokumenteve të vlerësimit.

Sipas vendimit nr.102/2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, por edhe vendimit nr.209, datë 11.10.2019, mbi Metodologjinë, Këshilli bazohet në shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati dhe atij të marrë nga subjekte publike apo private. Në rastin konkret, bazuar në këtë dokumentacion, më poshtë, sipas kategorive, kriterëve dhe nënkritereve për secilin nga ato, përshkruhen të dhënat që rezultojnë për kandidatin z.{...}.

#### **Kategoria “Meritat profesionale”**

Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”

Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”:

Sipas dokumenteve të administruara rezultoi se, kandidati z. {...} ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti "{...}" dhe është diplomuar "jurist" në dhjetor të vitit 2003 dhe dhënë betimin në datën 3.02.2004. Ndërkohë, sipas listës së rezultateve të provimeve, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti "{...}", sikundër edhe nga vetëdeklarimi i kandidatit në jetëshkrimin e tij, rezulton se mesatarja e studimeve të tij universitare 4-vjeçare është 8,2. Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", arsimi i kandidatit kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

Nënkriteri "Rezultatet e programeve të formimit fillestar":

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e përzgjedhjes për emërim, kandidati {...} nuk rezultoi të ketë ndjekur programe të formimit fillestar të tilla si Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike, etj. Për rrjedhojë kandidati nuk vlerësohet për këtë kriter.

Nënkriteri "Rezultatet e përvojës në profesion":

Në procedurën e përzgjedhjes për emërim, kandidati {...} paraqiti 4 (katër) opinione vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ai ka ushtruar profesionin, si më poshtë:

Vlerësimin e Rektorit të "{...}", Prof. Dr. {...}, që mban datën 09.12.2020 rezultoi se: "...". Është përshkrimi që i ka bërë vetë rektori i universitetit. Bashkëlidhur keni edhe vlerësimin e ish-Rektorit të "{...}", Prof. Dr. {...}, që mban datën 07.12.2020, i cili ka paraqitur edhe ky të gjitha vlerësimet dhe performancën e zotit {...}; Vlerësimi i Dekanit të "{...}", Prof. Assoc. {...}, që mban datën 07.12.2020; si dhe vlerësimi i ish-Rektorit të "{...}", Prof. {...}, që mban datën 07.12.2020, ku janë parashkruar e gjithë performanca e zotit {...}. I keni të gjitha në material dhe për efekt kohe nuk po i lexojmë.

Nënkriteri "Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë":

Sipas vendimit nr.102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit, për nënkriterin "Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë" vlerësohet dhe pikëzohet secili kriter specifik pjesë e tij.

"Rezultatet e trajnimeve të tjera":

Sipas jetëshkrimit të kandidatit, rezultoi që ai ka ndjekur trajnimet si vijon: Shtator 2017 – Shtator 2020 (tre javë), në kuadrin e Programit "Erasmus + Programme-

Jean Monnet Activities”, me tematike “E drejta e Refugjatit”, nga Universiteti i “{...}”, Tiranë. Në këtë kualifikim nuk është lëshuar dokument;

“Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare”:

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, rezultoi se ai, në vitin 2004–2005, ka ndjekur kualifikim pasuniversitar “{...}”, në Universitetin {...}, me notë mesatare 8.4 e ponderuar sipas kriterëve të Shkollës së Magjistraturës. Në mbledhjen e datës 11.02.2009, me nr. Regjistri {...}, Komisioni i Njohjes ka vendosur: Njohja e Diplomës së Studimeve Pasuniversitare të z.{...} nga Universiteti {...}, me program 1-vjeçar në Studime të Evropës Juglindore, si Diplomë e Nivelit të Dytë.

“Rezultatet e gradave/titujve shkencorë”:

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, rezultoi se ai, në vitet 2005 – 2011, ka ndjekur studimet në Universitetin {...}, duke marrë gradën shkencore “Doktor”, nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë “E drejta e Asociimit” dhe vlerësuar ‘Shkëlqyeshëm’. Me vërtetimin nr. {...} prot., datë 30.04.2013 të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë përcaktohet se grada e lartpërmendur, e fituar në {...} nga z. {...} është e barasvlershme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë. Grada e z. {...} është e regjistruar në regjistrin për gradat shkencore dhe titujt akademikë të mbrojtur jashtë vendit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, në datën 29.04.2013 dhe ka numrin rendor {...}.

Gjithashtu rezulton se me Dëshminë nr. {...}, me nr. Regjistri të KVTA {...} lëshuar me datë 15.01.2016 nga Universiteti {...}, kandidati {...} ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”.

Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore”:

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, rezultoi se ai zotëron katër gjuhë të huaja, “Anglisht”, ‘Greqisht’ ‘Italisht’ dhe ‘Gjermanisht’. Sipas deklarimit të bërë nga kandidati në jetëshkrim, niveli i zotërimit të gjuhës anglisht, greqisht dhe italisht është “shkëlqyeshëm” në të tre kriteret, të kuptuarit, të folurit dhe shkrim, ndërsa niveli i zotërimit të gjuhës gjermane është “shumë mirë” në tre kriteret, të kuptuarit, të folurit dhe shkrim. Për faktin e zotërimit të katër gjuhëve të huaja si më lart, kandidati ka depozituar (të njësuara me origjinalin):

Studimet Master dhe Doktoraturën e zhvilluar në gjuhën angleze.

Vërtetimi i gjuhës greke lëshuar nga Universiteti i Filozofisë {...} në vitin 1998, si dhe Diploma zyrtare e lëshuar nga Universiteti {...}.

Dëshmi e zotërimit të gjuhës italiane e lëshuar nga Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;

Dëshmi e zotërimit të gjuhës gjermane e lëshuar nga Universiteti {...}.

### **Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”**

Sipas vendimit nr.102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit, vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” bëhet përmes vlerësimit cilësor të punimeve dhe dokumenteve profesionale gjatë pesë viteve të fundit të karrierës, midis të cilave kandidati përzgjedh dhe i parashtron Këshillit, pesë ndër punimet më të dallueshme sipas tij, ku paraqiten aftësitë e tij intelektuale dhe profesionale në nivelin më të lartë. Po ashtu, elemente shtesë mbi cilësinë e rezultateve profesionale mund të nxirren edhe nga dokumentet zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional të paraqitura nga kandidati ose të kërkuara nga ana e Këshillit prej autoriteteve përkatëse, si edhe dokumentet zyrtare që paraqesin cilësinë dhe arritjet gjatë eksperiencës në punë, nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për efekt vlerësimi dhe pikëzimi sipas këtij kriteri, kandidati ka dorëzuar 5 (pesë) dokumentet si më poshtë: Ankimi kundër vendimeve nr. 24; 62; 58; 112 dhe 200. Janë parashtruar në akt të gjitha të dhënat për sa i përket këtyre ankimeve.

Për efekt vlerësimi dhe pikëzimi sipas këtij kriteri, kandidati ka dorëzuar edhe 12 (dymbëdhjetë) dokumente të tjerë, si vijon: ... dhe janë 12 ankime që kanë të bëjnë me ankimet kundër vendimeve 273, 221, 229, 269, 241, 249, 86, 187, 90, 61, 32, 42.

Po ashtu, për dokumentet sipas pikës 20.3.3 të këtij Relacioni, kandidatit iu kërkua dhe ai ka paraqitur vetëvlerësimet, si vijon: Dokumentin në gjuhën angleze “The Principle of Sovereignty as the main principle of democracy, between the political pluralism and the electoral system in the parliamentary Republic of Albania”. Në këtë artikull është përshkruar nocioni juridik i sovranitetit në Republikën e Shqipërisë dhe sistemi elektoral shqiptar. Kontributi i këtij artikulli në fushën e të drejtës civile lidhet me ushtrimin e të drejtave civile në sistemin pluralist shqiptar; dokumenti “The acquisition of the Swiss Nationality”. Ky artikull synon të analizojë përfitimet e shtetasve të huaj në marrjen e nënshtetësisë zvicerane. Këto përfitime janë në dy aspekte. Atë të së drejtës kushtetuese (e drejta e votës dhe e drejta për tu zgjedhur) dhe të së drejtës civile ku marrja e kësaj nënshtetësie ndikon në të drejtën e tatimit ku përfitimi i kësaj nënshtetësie sjell një nivel tatimi më të ulët.

Duke qenë se anëtarët i kanë të gjitha këto, mund t'i kalojmë këto vetëvlerësimet që ai ka paraqitur.

### **Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”**

Sipas vendimit nr.102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit, vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Kualifikimi shtesë profesional” synon të vlerësojë rëndësinë dhe dobinë e specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, në mënyrë që të sigurojë “plotësimin e ekspertizës” profesionale dhe të pasurojë kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë me profesionistë të spikatur sipas fushave respektive të së drejtës.

Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”:

Referuar jetëshkrimit si dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, rezultoi që ai, deri në momentin e kandidimit, të ketë përvojë profesionale si vijon: si avokat - 10 vjet pedagog në Shqipëri, 3 vjet e 9 muaj asistent profesor në Universitetin Kombëtar të Athinës si dhe 2 vjet Jurist. Në total, kandidati ka përvojë profesionale me kohë të plotë si avokat, si lektor i të drejtës dhe si jurist i nivelit të lartë në administratën publike përmbi 15 vjet (për më tepër mund të shikoni vendimin nr.560, datë 13.11.2020. Për rrjedhojë, rezultoi që kandidati të ketë mbi 15 vjet angazhim në fushën e së drejtës civile.

Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”:

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, rezultoi që ai ka paraqitur këto akte dhe artikuj shtesë lidhur me vlerësimin profesional:

Artikuj shkencorë në fushën e së drejtës, të botuar në revista shkencore dhe profesionale, të cilat janë të cituara të gjitha (janë 11 artikuj).

Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”:

Referuar jetëshkrimit si dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, rezultoi që ai ka dhënë kontribut në hartimin e legjislacionit. Konkretisht ai është bashkautor i një Komentari i draftit të kodit të punës i cili është një punim që ndikon në legjislacionin e kodit të punës. Ky komentari është hartuar nga katër ekspertë të fushës pas një kontrate me ILO në Gjenevë, institucion i cili në momentin e draftit të hartuar nga shteti shqiptar kërkonte një komentari të tijin për të kontribuar në legjislacionin e të drejtës së punës.

Konkretisht, për këtë nënkriter vlerësimi dhe pikëzimi, gjatë procedurës së përzgjedhjes për emërim u administruar këto dokumente si vijon: ... dhe përmendet komentari mbi të drejtën e punës.

Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”  
- “Pjesëmarrja në konferenca shkencore”:

Pjesëmarrja e kandidatit në konferenca shkencore rezultoi si vijon: ... Pra janë specifikuar të gjitha pjesëmarrjet e tij të cilat shkojnë deri në numrin 14.

“Mësimdhënie”:

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi se kandidati ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies, kryesisht në fushën specifike për pozicionin e lirë, atë të së drejtës civile, por edhe në fusha të tjera, si atë të drejtës tregtare, e drejtë detyrimesh, etj. Konkretisht ai ka një përvojë mbi 10-vjeçare si pedagog i së drejtës në Shqipëri/ Kosovë/ASPA etj. Gjithashtu bazuar edhe në dokumentacionin e dorëzuar vihet re që studimet Post–Doktorale janë kryer në shtetin e {...} ku kandidati ka qenë edhe i ftuar si “Guest Professor”. Gjithashtu edhe gjatë studimeve doktorale që janë kryer në shtetin e Greqisë ai ka pasur edhe një përvojë disavjeçare si pedagog (asistent profesor) në një vend të OECD, konkretisht në Universitetin Kombëtar të Athinës/Fakulteti i Drejtësisë.

Konkretisht kandidati ka mbajtur pozicionin e Shefit të Departamentit të ligjit dhe Drejtor i Programeve Master në Universitetin e {...}, Tiranë, ku ka qenë edhe profesor i lëndëve të drejtë tregtare, e drejtë civile, e drejtë të krahësuar civile.

Në Universitetin {...} ka mbajtur pozicionin e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë si dhe ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies në lëndët “E Drejtë Kushtetuese”, “E Drejtë Administrative” si dhe metoda kërkimi në shkencat juridike.

Në Universitetin {...} ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies në lëndët “E Drejtë Civile”, “Metoda Kërkimi”, si dhe “Shkrim dhe Arsyetim Ligjor”.

Në Universitetin Kombëtar të Athinës ka kryer veprimtarinë e mësimdhënies si asistent pedagog në lëndët “E Drejtë Kushtetuese” dhe “Të Drejtat Kushtetuese” në nivelin Bachelor dhe Master.

“Çmime dhe tituj”:

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi që kandidati të ketë marrë këto çmime dhe tituj:

1. Swiss Excellence Government Scholarship në nivel Post–Doktorature;
2. Onassis Foundation Scholarship për studentët ekselentë në nivel doktorature;
3. Bursë e akorduar nga Ministria e Jashtme e Republikës së {...} për studentët ekselentë që studiojnë në Universitet Kombëtare greke në nivel Master+Ph.D.

### **Kategoria “Meritat morale dhe etike”**

Sipas vendimit nr.102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori bazohet në atë nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së pritshme të gjyqtarit, referuar treguesve për këto kritere: 1) Shmangia e shfaqjes së pahijshme; 2) Nderi dhe dinjiteti, dhe 3) Reputacioni. Pikëzimi i kësaj kategorie vlerësimi sipas këtyre treguesve bëhet sipas një rendi zbritës, duke supozuar se kandidati ka integritet etik dhe moral të plotë. Sipas kësaj qasjeje, kandidati e fillon procedurën e vlerësimit me totalin e pikëve referuar secilit tregues të kësaj kategorie vlerësimi, dhe nëse burime të provuara dhe të besueshme evidentojnë një mangësi të treguesve të integritetit moral dhe etik, Këshilli cakton për kandidatin minimumin e pikëve (1 pikë). Të dhënat për vlerësim dhe pikëzim të kandidatit janë ato që rezultojnë nga gjetjet në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit apo informacione të tjera të verifikuara nga Këshilli.

Për kandidatin, gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, nuk rezultoi asnjë gjetje negative në raport me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi.

Po ashtu, për kandidatin, gjatë gjithë procesit të kandidimit nuk rezultoi ndonjë informacion tjetër negativ në lidhje me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi.

Nga ana tjetër, në lidhje me këtë kategori vlerësimi, janë administruar akte dhe opinione nga institucionet me të cilat kandidati ka pasur marrëdhënie pune dhe bashkëpunimi, nga të cilat nuk ka rezultuar asnjë koment negativ lidhur me figurën, moralin dhe integritetin e kandidatit.

Për këtë kategori vlerësimi mund të mbahen parasysh edhe të dhëna a përfundime që mund të rezultojnë gjatë intervistës së kandidatit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjatë procesit të kandidimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë që cenon prezumimin se kandidati gëzon integritet dhe moral të plotë.

### **Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”**

Sipas vendimit nr.102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori mban parasysh se gjyqtari duhet të ketë aftësi të mira organizative dhe menaxheriale në mënyrë që të jetë produktiv. Në këtë kuptim, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht punën. Produktiviteti, në çdo profesion



dhe detyrë, është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë kandidati përdor kohën e tij, si kur punon vetëm ashtu edhe në grup me të tjerë. Për të vlerësimin dhe pikëzimin e kësaj kategorie, Këshilli mbështetet në të dhëna të dala nga burime të tilla si: jetëshkrimi i kandidatit; intervista me kandidatin; dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e meritave organizative dhe meritave personale të tjera gjatë përvojave të punës; informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione shtetërore; informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë, si edhe informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill.

Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”:

Në dokumentin përshkrues mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë, kandidati ka parashtruar motivet që e kanë shtyrë atë për të kandiduar në Gjykatën e Lartë, si dhe objektivat që ai ka në rast se zgjidhet anëtar i Gjykatës së Lartë.

Në platformën e paraqitur, kandidati, fillimisht, ka bërë përshkrimin e rrugëtimit të tij profesional, rritjet në çdo detyrë të karrierës së tij, forcave të veta dhe CV-së së tij personale, si dhe kontributin e tij shumë vjeçar në sistemin e arsimit të lartë si dhe në organet e reja të krijuara për shkak të reformës në drejtësi si { ... }.

Motivi kryesor që e shtyn për t’u bërë gjyqtar dhe për të kërkuar një gjë të tillë përpara Këshillit, është rrjedhojë logjike e gjithë jetës së tij profesionale. Sipas kandidatit, zgjedhja e tij si anëtar i Gjykatës së Lartë është një mesazh inkurajues për ata të rinj dhe të reja, të cilët besojnë akoma se njerëzit e vetëkrijuar si ai mund të arrijnë shkallët më të larta të gjyqësorit shqiptar nëpërmjet punës dhe përkushtimit të tyre.

Në lidhje me objektivat, kandidati ka evidentuar së pari se udhërrëfyes për të gjithë veprimtarinë e tij si gjyqtar do të jetë aplikimi i standardeve më të larta të mbrojtjes të së drejtave të njeriut që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.

Kam parashtruar pra shkurtimisht të gjitha ato që kandidati ka paraqitur në jetëshkrimin dhe fjalën e tij.

Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse”:

Këshilli vlerëson për këtë kriter nivelin e aftësive të fituara në përvojën, pozicionet dhe përgjegjësitë e mbuluara, në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin dhe administrimin e punës.

Në lidhje me këtë kriter, kandidati ka sugjeruar që të vlerësohet, duke pasur parasysh: 1. Eksperiencën në pozicionin e Dekanit pranë Fakultetit të Drejtësisë/ Universiteti {...} – Vlerësimi i punës në institucion të arsimit të lartë paraqitet edhe në shkresën e këtij Universiteti;

2. Eksperiencën në pozicionin e Shefit të Departamentit të Drejtësisë pranë Universitetit të {...}Tiranë – Vlerësimi i punës në institucion të arsimit të lartë paraqitet edhe në shkresën e këtij Universiteti;

3. Eksperiencën si {...} pranë Institucionit të {...}.

Kriteri “Aftësitë e komunikimit”:

Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli vlerëson aftësinë për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe konçize. Këshilli vlerëson gjithashtu, edhe nëse kandidati është në gjendje të komunikojë me subjektet e tjera dhe të tretët në mënyrë jodiskriminuese, të matur dhe me respekt. Për këtë kriter, kandidati vlerësohet mbi bazën e të njëjtit dokumentacion që vlerësohet për kriterin “Aftësitë vendimmarrëse” sipas pikës 22.3 të këtij Relacioni apo edhe të dhënat që mund të rezultojnë nga intervista me kandidatin.

Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”:

Në lidhje me këtë kriter, Këshilli vlerëson eksperiencën e kandidatit gjatë karrierës, në punën në ekip dhe në ambiente multidisiplinore.

Në lidhje me këtë kriter, kandidati vlerësohet mbi bazë të të njëjtit dokumentacion që vlerësohet edhe për kriteret “Aftësitë vendimmarrëse” dhe “Aftësitë e komunikimit”, të cilat janë pjesë e këtij relacioni.

Këto janë veprimet e shqyrtuara nga Komisioni, të cilat në mbledhjen e datës 25.02.2021 është vendosur që t’i parashtrohen seancës plenare.

Më tej vijohet me aktin e vlerësimit dhe pikëzimit.

***Dritan Hallunaj***: Do mundohem të jem shumë i përmbledhur dhe mos t’ju ha kohën, gjithashtu të keni edhe kohën e duhur që të dëgjoni edhe vetë kandidatin dhe ta vlerësoni atë.

Për sa i përket kriterit “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”, janë parashtruar në këtë raport dokumentet mbi të cilat kam marrë parasysh pikëzimin e kandidatit, mesataren e tij universitare dhe pikëzimi për këtë kriter e vlerësoj me 1 pikë për shkak se referuar të dhënave të administruara, rezultati i arritur prej tij në studimet e larta për drejtësi është me notën mesatare 8–9 dhe duke pasur parasysh historikun arsimor dhe kur nota mesatare 8–9 vlerësohet me 1 pikë.

Gjithashtu nuk rezulton që kandidati të ketë ndjekur formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë apo Shkolla e Administratës Publike, dhe për këtë e kam vlerësuar me 0 pikë.

Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” e vlerësoj me 4 pikë për arsye se referuar të dhënave, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve si më lart, ku kandidati bën pjesë, rezulton se ai ka dhënë kontribut për çdo detyrë që i është ngarkuar, ka treguar profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe përpikëri.

Duke pasur parasysh dokumentet mbi trajnimet që ka kryer dhe gradat shkencore, e vlerësoj për trajnimet me 0 pikë.

Ndërsa për kualifikimet pasuniversitare 1.5 pikë dhe për gradat shkencore me 4 pikë.

Gjithashtu për aftësitë gjuhësore të treguara nëpërmjet certifikatave (pastaj do ta vlerësojmë edhe gjatë intervistimit), duke pasur parasysh vërtetimet e lëshuara nga Universiteti Kombëtar i Athinës, nga Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, etj., unë e kam vlerësuar me 3.5 pikë.

Për “Kualifikimin e përgjithshëm profesional”, që ka të bëjë me vlerësimin e punës së kandidatit nëpërmjet 5 dokumenteve të paraqitura, unë e kam vlerësuar personalisht me pikëzimin maksimal për arsye të cilat janë të detajuara edhe në vendimmarrje. Për secilën ka marrë 5 pikë.

Duke vijuar me specializimin në fushën e së drejtës civile, penale apo administrative, duke pasur parasysh “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”, “Botime relevante...”, “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” si dhe “Pjesëmarrja në konferenca”, e kam vlerësuar:

“Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” – 6 pikë; “Botime relevante...” profesionale në fushën specifike” – 6 pikë; “Botimet relevante...” – 3 pikë; “Pjesëmarrja në konferenca...” – 10 pikë;

Integriteti moral dhe etik:

“Shmangia e shfaqjes së pahijshme” – kam dhënë pikët maksimale duke qenë se nuk kemi ndonjë të dhënë që ndikon në uljen e pikëve – 5 pikë; “Nderi dhe dinjiteti” – 5 pikë; “Reputacioni” – 5 pikë;

“Meritat organizative dhe menaxheriale”:

“Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” – kam dhënë pikët maksimale 2 pikë; “Aftësitë vendimmarrëse” – 4 pikë (maksimale); “Aftësitë e komunikimit” – 2 pikë; “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” – 2 pikë (maksimale);

Në total kam paraqitur edhe tabelën e rezultatit të pikëve, ku me totalin e pikëve për renditjen e kandidatit e kam vlerësuar duke mbledhur të gjithë këto komponentë që citova, me 89 pikë.

Këto janë. Unë jam i hapur për çdo pyetje, sqarim që ka.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Hallunaj!

Në respektim të procedurës që është parashikuar në vendimin nr.102, datë 05.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me kriteret e vlerësimit dhe pikëzimit të renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim, një nga çështjet që do shtrojmë përpara në Këshill është që nëse nga ana e Këshillit vlerësohet që janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme dhe veprimet përgatitore për plotësimin e dokumentacionit të kandidatit. Jemi dakord mbi plotësimin e veprimeve procedurale?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Duhet ta fillonim nga komisioni në fakt.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Edhe unë si anëtar zëvendësues, dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë tek çështja tjetër, po në zbatim të vendimit që ka të bëjë me miratimin e projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit.

Zoti Hallunaj bëri një relativitet të detajuar lidhur me propozimin paraprak për sa i përket vlerësimit dhe pikëzimit.

Nëse nga ju ka diskutim lidhur me vlerësimin paraprak?

Po zonja Ukperaj!

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë jam dakord me të gjitha propozimet që ka bërë relatori në projekt-aktin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit. Kam vetëm dy diskutime që lidhen me pikëzimin lidhur me kriterin e “Aftësive gjuhësore” dhe pikëzimin lidhur me nënkriterin e “Botimeve relevante dhe ndikimit të rezultateve profesionale në fushën specifike”.

Për sa i përket “Aftësive gjuhësore”, nga ana e relatorit është bërë pikëzimi me 3.5 pikë (1.5 pikë është bërë për zotërimin e gjuhës angleze dhe 2 pikë të tjera janë bërë për vlerësimin e gjuhës italiane dhe asaj gjermane). Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kur flasim për aftësitë gjuhësore, është parashikuar që Këshilli vlerëson me përparësi zotërimin nga ana e kandidatit të gjuhës angleze dhe gjuhës frënge. Në këtë rast nuk kemi njohuri në gjuhën frënge, ndërkohë që për të gjitha gjuhët e tjera, në varësi të nivelit të zotërimit, Këshilli mund të përcaktojë vetëm deri në 1 pikë, pra jo 1 pikë për secilën gjuhë, por 1 pikë në total. Unë do të kisha propozimin që në këtë rast, nga 3.5 pikë, të shkonim në 2.5 pikë. Pra jo 1 pikë për secilën gjuhë, por 1 pikë në total për të dyja gjuhët që zotëron.

Propozimi im i dytë, duke qenë se aktualisht jemi në projektvlerësimin paraprak dhe kemi të dhëna të cilat nuk duhet t’i vlerësojmë tani dhe nuk mund t’i reflektojmë në një kohë të mëvonshme, sepse të dhënat janë mbledhur nga ana e relatorit, është për sa i përket kontributit në fushën specifike në të cilën kandidon zoti {...}. Ai kandidon si gjyqtar në fushën e së drejtës civile dhe për sa i përket kontributit specifik duhet të ketë kontribut specifik pikërisht në fushën e së drejtës civile.

Nga të dhënat dhe përshkrimi i botimeve që ka realizuar zoti {...} në të gjithë karrierën e vet profesionale rezulton që shumica e botimeve të realizuara në fakt kanë qenë për sa i përket të drejtës publike, në të drejtë kushtetuese apo në të drejtë europiane, të cilat indirekt mund të interferojnë dhe të jenë relevante për elementë të caktuar të së drejtës civile, por nuk kanë qenë një kontribut i drejtpërdrejtë i tij në fushën e së drejtës civile. Po të shikojmë edhe specializimin e zotit {...}, në fakt ka qenë një specializim i kombinuar, edhe masteri edhe doktoratura në të drejtën e asocimit, edhe post doktoratura

që ka bërë, por edhe botimet relevante që ka bërë, që janë kryesisht në fushën e së drejtës europiane. Jam dakord që ka një ndikim kontributi dhe botimet e zotit {...} në të drejtën ndërkombëtare, por nuk janë posaçërisht dhe të drejtpërdrejta që interferojnë në të drejtën civile. Për këtë arsye, nga 6 pikë unë do të propozoja 3 pikë.

**Klodian Kurushi:** Nënkriteri?

**Brikena Ukperaj:** “Botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”. Ndërkohë që për të gjitha vlerësimet e tjera jam dakord.

**Naureda Llagami:** Ia jap fjalën relatorit.

**Dritan Hallunaj:** Nëse ka ndonjë anëtar tjetër ndonjë ndryshim, apo ndonjë kërkesë, që pastaj të shprehem për të gjitha bashkë?

**Naureda Llagami:** Ndonjë koleg tjetër?

Jo!

**Dritan Hallunaj:** Atëherë, meqenëse nuk ka, jam plotësisht dakord me atë që propozon zonja Ukperaj dhe jam pro që të ndryshoj pikëzimin për sa i përket “Aftësive gjuhësore” nga 3.5 pikë në 2.5 pikë, si dhe për sa i përket kualifikimeve shtesë që kanë të bëjnë me specializimin në fushën e së drejtës civile, penale apo administrative, nga 6 pikë në 3 pikë. Kjo reflektohet pastaj në totalin 85 pikë.

Pra totali i pikëve për renditjen e kandidatit shkon 85 pikë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, jeni dakord me propozimin?

Pra keni pranuar propozimin e bërë nga zonja Ukperaj.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

Më fal, mund ta lexoj unë vendimin?

**Naureda Llagami:** Po!

(Lexohet dispozitivi i vendimit nga zoti Hallunaj.)

**Dritan Hallunaj:**

1. Miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Miratimin e listës me kandidatët më të mirë, si më poshtë: 1. Z. {...}.

3. Zhvillimin e intervistës me kandidatin z. {...} më datë 25.03.2022 (meqenëse sot është njoftuar dhe është paraqitur).

**Klodian Kurushi:** Dakord jam edhe unë me propozimet e bëra nga kolegu.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraprak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Miratimin e listës me kandidatët më të mirë, si më poshtë: 1. Z. {...}.

3. Zhvillimin e intervistës me kandidatin z. {...} më datë 25.03.2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Administrata të bëjë të mundur që të vijë kandidati në sallë, për të vijuar me intervistën.

*(Futet në sallën e mbledhjes kandidati z. {...}.)*

**Naureda Llagami:** Përshëndetje, zoti {...}!

Mirë se erdhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor!

Në zbatim të procedurës, pasi nga ana e Këshillit janë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me verifikimin dhe propozimin paraprak për vlerësimin tuaj, procedura parashikon edhe një intervistim për të pasur më të qartë lidhur me kandidimin tuaj për në Gjykatën e Lartë.

Intervistimi do të thotë që, nga ana e anëtarëve mund të ketë pyetje lidhur me arsyet pse jeni sot përpara Këshillit për të kandiduar në Gjykatën e Lartë.

Në cilësinë e Kryetares do të doja të filloja e para me pyetjen:

Kush janë arsyet dhe motivet e këtij kandidimi nga ana juaj?

{...}: Faleminderit, zonja Kryetare!

Faleminderit të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Shqipërisë.

Arsyeja e motivimit tim për të aplikuar në pozicionin vakant si kandidat pranë Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nuk është vetëm një, ndoshta janë disa arsye. Arsyet e para kanë të bëjnë me eksperiencën time profesionale, por gjithashtu edhe jetësore. Besova që në momentin e kandidimit kishte ardhur koha që unë duhet aplikojta sepse e shikoja veten të kompletuar si nga ana e eksperiencave mësimore (edukimi im), i cili sikurse e keni parë CV – në time, është kryer jashtë Shqipërisë, por gjithashtu edhe me eksperiencën profesionale e cila nis në disa sektorë dhe përfundon, dhe do të vazhdojë (shpresoj) gjithashtu në fushën e drejtësisë si {...}.

Eksperiencën e fundit 4-vjeçare unë e rendis si një eksperiencë shumë të rëndësishme e cila më ka përmbushur dhe më ka pajisur mua me elementët e duhur për të përballuar sfidën e re, në qoftë se unë do të jem anëtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.

**Naureda Llagami:** Ftoj kolegët nëse kanë pyetje.

*(Zoti Hallunaj e pyet kandidatin nëse ka dëshirë të parashtrojë objektivat që i ka paraqitur me shkrim përpara Komisionit.)*

{...}: Unë kam bërë disa objektiva të cilat i kam shkruar.

Mund të vazhdoj?

Faleminderit!

Në rast se unë do të jem anëtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, unë kam menduar disa sfida të cilat do të më presin, sfida të cilat kthehen pastaj edhe në objektiva të mi.

Së pari, ne dëgjojmë vazhdimisht që Gjykata e Lartë ka një numër shumë të madh çështjesh. Gjithashtu, problemet që lindin me zbatimin dhe vendimet që duhet të marrin vendimet e njësitit dhe të zbatimit të praktikës që duhet të marrin gjykatësit e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.

Me eksperiencën time modeste do përpiqem maksimalisht që në bashkëpunim me Njësinë Ligjore, ku shërbimin ligjor unë e njoh shumë mirë nga eksperiencia aktuale, të



jap më të mirën që të ulë numrin e çështjeve sepse kjo do jetë detyra, sfida dhe objekti i parë që më pret në Gjykatën e Lartë.

Vendimmarrja e sa më shumë vendimeve njësuere ose unifikuese, duke vendosur standarde të cilat duhet të ndiqen më pas nga gjykatat më poshtë.

Gjithashtu një tjetër sfidë e imja personale është aplikimi i standardeve sa më të larta për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin si nga instrumentet ndërkombëtare ashtu edhe nga ligjet e brendshme të shtetit shqiptar.

Gjithashtu publikimi në kohë i çdo vendimi është shumë i rëndësishëm.

Pjesëmarrja në forume ndërkombëtare – Duke qenë se unë si njeri flas gjuhët e huaja në një nivel goxha të mirë, disa prej tyre, dhe eksperiencia ime jashtë shtetit, do doja si anëtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, të kisha mundësinë që të përfaqësoja gjykatën, pra shtetin shqiptar, në forume ndërkombëtare, duke mbështetur maksimalisht shtetin tim dhe gjykatën në të cilën unë dëshiroj të bëj pjesë, për ta çuar sa më përpara punën atje.

Këto besoj do jenë disa nga sfidat e mia dhe objektivat e mia, shkurtimisht.

Për pyetje jam i hapur në qoftë se doni të bëni.

***Dritan Hallunaj:*** Ju dëgjova shkurtimisht me parashtrimet tuaja gjithashtu kam pasur parasysh edhe platformën që keni paraqitur në fillim përpara Këshillit, por duke menduar dhe duke vijuar me ato që ju cituat, cila mendoni ju se është problematika kryesore aktuale në Gjykatën e Lartë dhe çfarë mendoni ju që mund të bëni ju me punën tuaj për të rregulluar atë moment apo atë praktikë të cilën ju e vlerësoni?

*{...}*: Faleminderit!

Sfida më e madhe është një sfidë e njohur tashmë, është numri i lartë i çështjeve në Gjykatën e Lartë. Zgjidhja që unë mendoj është vendimmarrja e numrit sa më të madh nga ana jonë e vendimeve, njësimi dhe unifikimi të praktikës, në mënyrë që ne të unifikojmë disa vendime, në mënyrë që këto vendime të bëhen si kategori, në mënyrë që të fusim vendimet e tjera në këto kategori. Pra ne të ndërtojmë një autostradë me katër pika (për shembull) dhe në këto katër pika do vendosen vendimet, në mënyrë që ne të ecim sa më shpejt. Pra vendimmarrje e shpejtë e imja dhe puna që pres të jetë një punë voluminoze nga e cila unë nuk kam frikë aspak, përkundrazi unë jam mësuar në institucionin tim dhe e di shumë mirë. Ndoshta edhe vendosja e afateve, nga eksperiencia ime personale në drejtimin e institucionit tim, mendoj që në bashkëpunim me Njësinë

Ligjore, duhet të ketë afate në dorëzimin e relacioneve, në mënyrë që puna të eci shumë shpejt. Konkretisht, një dosje e cila është 1500 – 2000 faqe, ne arrijmë ta mbarojmë për 4–5 ditë. Kështu që, besoj që e njëjta gjë duhet të ndodhë edhe në atë gjykatë. Faleminderit!

**Klodian Kurushi:** Përshëndetje zoti {...}!

Unë jam Klodian Kurushi, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe do doja t'ju bëja një pyetje.

Brenda mundësive, nëse juve mundeni të na jepni një mendim, se cilët janë, në mënyrë të përmbledhur, elementët e formimit tuaj si jurist dhe cila është përvoja juaj personale që ka përligjur kërkesën tuaj për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë?

**{...}:** Faleminderit!

Përvoja profesionale e një njeriu nuk mund të ndahet kurrë me thikë se kush është ndoshta më e rëndësishmja, por sigurisht përvoja profesionale katërvjeçare besoj ka qenë determinante për të qenë pjesë e gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë; është një përvojë e cila për mendimin tim personal... – përballja me Kolegjin e Posaçëm të Apelit është eksperiencë e pasur gjyqësore; – vendimmarrja ime është një vendimmarrje që ka një peshë shumë të madhe, ndoshta, kjo mbetet për t'u parë, ndoshta më e madhe se atje ku unë shkoj, sepse me një firmë unë marr vendimin se çfarë do të ndodhi me jetën profesionale të një subjekti rivlerësimi; gjithashtu nuk do mënjanoja edhe përvojat e tjera profesionale në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, por edhe jashtë Shqipërisë; – përvoja si profesor është një përvojë shumë e madhe e cila ndihmon, sepse të qenit gjyqtar nuk është vetëm praktikë, është kryesisht praktikë, por kryesisht, gjithashtu, duhet të jetë edhe teori dhe lexim; – gjuhët e huaja gjithmonë janë një avantazh sepse ndihmojnë gjyqtarin, por edhe profesorin, të avancojë teorinë e tij, por edhe praktikën e tij. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Përshëndetje, zoti {...}!

Unë jam Ilir Rusi, anëtar, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke ju përgëzuar për kandidimin tuaj dhe vijimin e mëtejshëm të procedurave, do doja t'i referohesha eksperiencës, që edhe ju e theksuat dy herë, si {...}, gjatë kësaj

eksperience, cila ka qenë dilema etike–profesionale më sfiduese për ju dhe si jeni munduar apo si jeni referuar për ta zgjidhur atë?

*{...}*: Faleminderit, zoti Rusi!

Është e vërtetë që në punën aktuale unë kam pasur shumë dilema, sepse vendimmarrja ime ishte një vendimmarrje dhe është një vendimmarrje e cila pothuajse ishte definitive në kokën time, por edhe në vendimmarrje dhe këtë e tregojnë përqindjet e suksesit të vendimmarrjeve të dy {...}, të miat dhe të kolegut tim. Kështu që, kjo ma rriste shumë presionin kur unë duhet të vendosja për ankim ose jo ndaj një subjekti. Por dilemat morale njeriu gjithmonë i zgjidh me veten e tij, duke folur me veten e tij. Kisha arritur dhe kam arritur në një pikë që vendimmarrjet i merrja gjithmonë i vetëm, i ulur në kolltukun e zyrës time, duke biseduar me veten time.

Në rast se unë do të kisha ato të meta, do të arrija të çoja subjektin? – Përgjigjja është jo! Unë do isha me subjektin. Pra unë jam përpjekur të jem gjithmonë objektiv dhe të kem një standard të njëjtë. Në qoftë se unë vendos notën 5 (meqenëse ju jeni koleg i imi), atëherë nota 5 duhet të jetë për të gjithë të tjerët. Në qoftë se ne lëvizim tek nota, atëherë pastaj nuk është më dilemë, është një problem. Dhe unë kam qenë gjithmonë në një standard, pavarësisht se puna jonë shpeshherë interpretohet, shumë herë interpretohet ndoshta. Unë jam përpjekur të mbaj një standard. Ju faleminderit!

***Ilir Rusi***: Donit të thoshit “interpretohet” apo “komentohet”?

*{...}*: Interpretohet.

***Ilir Rusi***: Faleminderit!

*{...}*: Faleminderit juve!

***Naureda Llagami***: Atëherë edhe një pyetje në fund.

Duke parë raportin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Gjykatën e Lartë, çfarë mendimi keni juve, çfarë mund të bëjë Këshilli i Lartë Gjyqësor më mirë për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë?

*{...}*: Ju faleminderit për pyetjen!

Aktualisht duke e parë (unë jam një faktor i jashtëm dhe nuk jam faktor i brendshëm, siç mund ta njohin faktorët e brendshëm, ata ndoshta japin përgjigjen më të saktë), duke qenë se ju jeni ajo që quhet me të drejtë qeveria e gjyqësorit, mendoj që roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor është asistimi në pjesën e gjyqtarëve, pra mendoj se KLGJ-ja duhet të ketë syrin dhe vëmendjen tek Njësia e Shërbimit Ligjor. Pra gjyqtarët janë të pajisur në numër me këshilltarë dhe me këshilltarët e duhur? – Pasi, në realitet këshilltarët ligjorë të një institucioni ligjor (dhe këtë e them marrë shkas edhe nga detyra aktuale) janë zemra e një institucioni dhe mendoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të përqendrohet tek Njësia e Shërbimit Ligjor, tek numri dhe cilësia e tyre.

**Naureda Llagami:** Dakord!

Faleminderit për intervistën dhe mund të vazhdoni për të lejuar Këshillin të vijojë me procedurën e vlerësimit.

*(Largohet nga salla e mbledhjes kandidati z. {...}.)*

**Naureda Llagami:** Në zbatim të rregullores, pas dëgjësës së kandidatit, secili nga anëtarët do të përfundojë aktin e pikëzimit dhe të vlerësimit për kandidatin. Kështu që, për t'ju dhënë kohë, besoj 30 minuta është e mjaftueshme?

Atëherë, brenda 30 minutave të përpilohet akti i vlerësimit dhe t'i përcillet/depozitohet relatorit, me qëllim për të vijuar më tej...

*(Pas dëgjësës me kandidatin për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, anëtarët e Këshillit tërhiqen për të bërë pikëzimin dhe vlerësimin e tyre, pikëzim të cilin do ta depozitojnë tek anëtari relator.)*

*Rifillon mbledhja nëpërmjet platformës “online” – ora 12:08.*

*1.3 Vijimi i procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit përfundimtar të kandidatit, z. {...}, që konkurron për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

**Naureda Llagami:** Viojmë me vlerësimin e kandidatit, z. {...} për në Gjykatën e Lartë.

Pas tërheqjes që bëri Këshilli i Lartë Gjyqësor, secili nga anëtarët ka bërë vlerësimin e tij lidhur me çdo kriter vlerësues për kandidatin në Gjykatën e Lartë.

Pa humbur kohë, fjalën ia jap relatorit, i cili do të propozojë vlerësimin e tij përfundimtar për kandidatin.

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, pasi relatuam aktin e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, që ishte akti paraprak, pra vetëm nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës së përzgjedhjes, si dhe pas intervistimit të kandidatit, i cili ishte prezent në seancë dëgjimore, përfundimisht unë nuk kam ndonjë ndryshim në totalin e pikëve, gjithashtu nuk kam ndryshim për sa i përket kritereve, duke filluar:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”;

2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”;

3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”;

B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”;

C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”;

Pra duke mos pasur ndonjë ndryshim nga raporti i miratuar përpara seancës dëgjimore, përfundimisht në total është 85 pikë, duke përfshirë edhe ndryshimin që u bë mbi kërkesën e zonjës Ukperaj.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Ndërkohë, vijojmë me anëtarët e tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, konkretisht zotin Kurushi dhe më tej anëtarin zëvendësues, Zëvendëskryetari Ilir Rusi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë, edhe unë në vijim të vlerësimit që dha kolegu ynë, mbështes totalisht këtë vlerësim dhe vlerësimi im i dorëzuar fizikisht ndaj tij është në vlerësimin total (nëse ju dakordësoheni) që i jap është 85 pikë. Nëse dakordësoheni, unë mund të kalojë specifikisht për çdo nënndarje për pikët konkrete. Nëse jo, 85 pikë është totali që unë vlerësoj t’i jap kandidatit për në Gjykatën e Lartë.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Kurushi!

Do i depozitoni në këto momente pranë relatorit për të vijuar më tej.

Kalojmë tek zoti Rusi.

**Ilir Rusi:** Faleminderit, Kryetare!

Duke iu referuar seksioneve të tabelës dhe zërave të pikëve, vlerësimi im do jetë si më poshtë:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”- totali është 13 pikë.
  2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” - totali është 25 pikë.
  3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional” - totali është 22 pikë.
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike” – totali është 15 pikë.
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale” - totali është 10 pikë.

Në total vlerësimi është 85 pikë, referuar një vlerësimi të njëjtë edhe me kolegët e deritanishëm. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Rusi!

Të lutem të depozitohet pranë relatorit vlerësimi juaj.

Ndërkohë kalojmë tek zonja Irena Plaku.

**Irena Plaku:** Faleminderit!

Vlerësimi për sa i përket kandidatit {...} është si më poshtë:

- A. Kategoria “Meritat profesionale” – 60 pikë.
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike” – 15 pikë.
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale” - 10 pikë.

Në total 85 pikë është vlerësimi përfundimtar nga ana ime. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Plaku!

Edhe ju vijoni me dorëzimin.

Kalojmë tek zoti Hado.

**Ridvan Hado:** Edhe vlerësimi im në total është 85 pikë duke qenë dakord me vlerësimet e bëra në çdo kategori nga relatori.

“Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”- 13 pikë.

“Kualifikimi i përgjithshëm profesional” - 25 pikë.

“Kualifikimi shtesë profesional” - 22 pikë.

“Meritat morale dhe etike” – 15 pikë.

“Meritat organizative dhe menaxheriale” - 10 pikë.

Në total 85 pikë.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit, zoti Hado!

Edhe ju depozitoni vlerësimin.

Kalojmë tek zonja Shehu.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Edhe unë kam hartuar aktin e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatin zotin {...}.

Nuk po ndalem specifikisht në të gjitha kriteret, duke qenë se dakordësohem në secilin prej tyre me vlerësimin që është propozuar nga relatori. Kështu që, përfundimisht vlerësimi im për këtë kandidat është 85 pikë.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Fjala është për zonja Rupa.

**Yllka Rupa:** Faleminderit, Kryetare!

Vlerësimi im për kandidatin {...} për kriteret dhe nënkriteret që pasqyrojnë kuadrin e plotë të vlerësimit dhe pikëzimit lidhur me meritat profesionale është gjithashtu në total 85 pikë.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit, zonja Rupa!

Edhe ju duhet ta depozitoni tashmë pranë relatorit.

Kalojmë tek zonja Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Edhe unë kam përgatitur aktin e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit {...}, bazuar në materialet e mbledhura gjatë procedurës së përzgjedhjes, në diskutimet e bëra

në seancën e sotshme dëgjimore dhe intervistën e kandidatit, kam vlerësuar që në tërësi, pikëzimi i tij të jetë i njëjtë me atë që ka bërë edhe relatori, në pikëzimin total përfundimtar me 85 pikë.

“Meritat profesionale” – 60 pikë.

“Meritat morale dhe etike” – 15 pikë.

“Meritat organizative dhe menaxheriale” - 10 pikë.

Aktin do ta depozitoj fizikisht edhe pranë relatorit.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Edhe unë në cilësinë e anëtares dhe Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor kam të njëjtin qëndrim sikurse edhe relatori lidhur me vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit, z. {...}, pa dashur të ndalem në secilën rubrikë. Në total, vlerësimi për kandidatin është 85 pikë.

Pasi të gjithë anëtarët bënë vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit dhe ia dorëzuan të nënshkruar Komisionit, tashmë fjalën e ka relatori lidhur me propozimin për vlerësimin përfundimtar.

**Dritan Hallunaj:** Doja të vija në dijeni që gjatë kohës që po merreshim me pikëzimin, të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur pranë meje aktet e vlerësimit për kandidatin {...} dhe unë jam i gatshëm që të vijojë me pjesën tjetër. Kështu që mund të vijoj?

**Naureda Llagami:** Po, patjetër!

**Dritan Hallunaj:** Meqenëse të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë depozituar aktet e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatin {...}, për secilin kriter dhe grupkriter, kam përgatitur listën dhe në vijim të vendimit nr.102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” rezultati i pikëzimit për secilin prej kriterëve për kandidatin rezulton nga pjesëtimi i shumës së pikëve totale të caktuara nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes, me numrin e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës të Këshillit. Kështu pra, përfundimisht, në vijim,



po ju detajoj vlerësimin përfundimtar që paraqet Këshilli si rezultat i formulës të cilën e citova më lart.

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatit, z. {...}, është si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” – 1 pikë;

b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” – 0 pikë;

c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” – 4 pikë;

ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:

i) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” – 0 pikë;

ii) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” – 1,5 pikë;

iii) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” – 4 pikë;

d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” – 2,5 pikë;

2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:

a) Indikatorit “Origjinaliteti dhe/ose impakti” – 5 pikë;

b) Indikatorit “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” – 5 pikë;

c) Indikatorit “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” – 5 pikë;

ç) Indikatorit “Interpretimi i harmonizuar” – 5 pikë;

d) Indikatorit “Referencat e praktikës gjyqësore” – 5 pikë;

3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:

a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” – 6 pikë;

b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” – 3 pikë;

c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” – 3 pikë;

ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësime, çmime dhe tituj”:

i) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” – 4 pikë;

ii) Treguesi “Mësime” – 6 pikë;

iii) Treguesi “Çmime dhe tituj” – 0 pikë;

B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:

1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” – 5 pikë;

2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” – 5 pikë;

3. Kriteri “Reputacioni” – 5 pikë;

C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:

1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” – 2 pikë;

2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” – 4 pikë;

3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” – 2 pikë;

4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” – 2 pikë;

Totali 85 pikë.

Ky është projektvendimi përfundimtar i cili duhet të miratohet nga anëtarët e Këshillit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit zoti Hallunaj për relatimin e vendimit përfundimtar të pikëzimit dhe të vlerësimit të kandidatit {...}.

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim nga kolegët, unë do të propozoja që ta votonim, duke respektuar rregullin që kemi parashikuar që fillimisht votohet nga Komisioni dhe më pas nga kolegët.

**Dritan Hallunaj:** Si relator jam pro propozimit.

**Klodian Kurushi:** Si Kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës jam dakord me propozimin dhe me pikëzimin e bërë për kandidatin {...}.

**Ilir Rusi:** Si anëtar zëvendësues në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës jam pro propozimit të këtij vlerësimi.

**Irena Plaku:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord me vlerësimin e bërë për kandidatin {...}.

**Marçela Shehu:** Dakord dhe përgëzime relatorit për punën e kryer.

**Yllka Rupa:** Dakord me propozimin lidhur me pikëzimin dhe renditjen e kandidatit.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” – 1 pikë;

- b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” – 0 pikë;
- c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” – 4 pikë;
- ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
  - i) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” – 0 pikë;
  - ii) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” – 1,5 pikë;
  - iii) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” – 4 pikë;
- d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” – 2.5 pikë;
- 2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:
  - a) Indikator “Originaliteti dhe/ose impakti” – 5 pikë;
  - b) Indikator “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” – 5 pikë;
  - c) Indikator “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” – 5 pikë;
  - ç) Indikator “Interpretimi i harmonizuar” – 5 pikë;
  - d) Indikator “Referencat e praktikës gjyqësore” – 5 pikë;
- 3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:
  - a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” – 6 pikë;
  - b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” – 3 pikë;
  - c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” – 3 pikë;
  - ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësime, çmime dhe tituj”:
    - i) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” – 4 pikë;
    - ii) Treguesi “Mësime” – 6 pikë;
    - iii) Treguesi “Çmime dhe tituj” – 0 pikë;
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
  - 1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” – 5 pikë;
  - 2. Kriteri “Nderi dhe dinjteti” – 5 pikë;
  - 3. Kriteri “Reputacioni” – 5 pikë;
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:
  - 1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” – 2 pikë;
  - 2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” – 4 pikë;
  - 3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” – 2 pikë;

4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” – 2 pikë;

Në total 85 pikë.

Me kaq e mbyllim këtë çështje të rendit të ditës.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.*
7. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*(Përfshihen “online” zoti Toro dhe zonja Luli, të cilët nuk morën pjesë në shqyrtimin e çështjes së parë.)*

*Naureda Llagami:* Duke vijuar me rendin e ditës, kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...}.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit të çështjes, zotit Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 04.03.2022 është depozituar një kërkesë me shkresë protokolluar me nr.{...} prot., nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit. Kërkesa është e pashoqëruar me referencën përkatëse ligjore, por në kushtet kur ky institut rregullohet nga neni 65, relatori ka vijuar për të trajtuar problemin në fjalë bazuar në këtë nen.

Gjyqtarja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 21.06.1992 dhe me vendim nr. {...}, datë 03.04.1992 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Berat. Me vendim nr. {...}, datë 20.11.1992 të Këshillit të Lartë Drejtësisë lirohet nga detyra ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Me vendim nr. {...}, datë 20.10.1993 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më pas znj. {...} me vendim nr. {...}, datë 04.02.1994 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtroj detyrën.

Në kërkesën e saj, gjyqtarja znj. {...} ka parashtruar: “ .. Më lejoni, që përmes kësaj kërkesë, unë {...}, me detyrë Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’ju paraqes dorëheqjen time, nga statusi i gjyqtarit dhe funksioni i Gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar shkaqet dhe motivet që më shtyjnë të marr një vendim të tillë ekstrem, në adresë të karrierës sime. Së pari: Jam diplomuar në Fakultetin Juridik, Dega Drejtësi, dhe ushtroj detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë prej afër 28 vjetësh. Gjatë kësaj periudhe e kam bazuar punën time në përkushtimin ndaj detyrës, në përkushtimin profesional dhe pastërtinë morale. Në aspektin personal evidentoj faktin se detyra e gjyqtares që mu ngarkua 28 vite më parë, ka qenë realisht për mua një punë dhe detyrim që ia vlente të kryhej, një mision tek i cili besova dhe do të besoj deri në fund të jetës sime. Se dyti: Pavarësisht pasionit tim për profesionin e gjyqtarit, me bindjen se përvoja ime si gjyqtare do të më vlejë, tani e tutje aktivitetin tim profesional do ta vazhdoj me të njëjtin përkushtim, jashtë sistemit gjyqësor dhe çmoj se përvojën që kam, mund ta përdor në dobi të një aktiviteti tjetër me më pak ngarkesë. Më është ofruar një mundësi profesionale dhe me preferencën dhe ekspertizën time në fushën e shoqërive tregtare, kam vendosur të ndjek një stad të ri në karrierën time. Se treti: Koha në të cilën po jetojmë është tej e ngarkuar me ngjarje e fenomene të drejta e të pa drejta, periudha që po kalon sistemi i drejtësisë veçanërisht gjyqësori shqiptar, i cili është në një kolaps të plotë, me bën të mendoj dhe arsyetoj duke zgjedhur me maturi vendin se ku mund të kontribuojë më mirë.

Për të gjitha këto arsye, dhe shumë e ndërjegjshme për rëndësinë e këtij akti me liri të plotë, unë kërkoj të më aprovoni dorëheqjen time nga detyra e gjyqtarit, detyrë të cilën u përpoqa ta kryej me zemër dhe profesionalizëm, me bindjen se askush nga ne nuk është imun ndaj gabimeve mund të them se ka qenë një nder i jashtëzakonshëm që të ushtroj detyrën e Gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë...”

Instituti i dorëheqjes është një institut që rregullohet nga neni 65 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, një akt vullnetar dhe si i tillë ai merret në konsideratë nga institucioni i cili verifikon, konfirmon dhe deklaron dorëheqjen, mjafton që ky vullnet të jetë i qartësuar dhe i siguruar pranë këtij institucioni. Një fakt i tillë është provuar nga zonja në fjalë, e cila e ka paraqitur dorëheqjen me shkrim dhe si i tillë, duke u bazuar në vullnetin e magjistrates, relatori ju propozon projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 29.04.2022.

3. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...}, nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim. Nëse jo, votojmë.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.



***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 29.04.2022.

3. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...}, nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këto dy pozicione, dhe përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

- 9. Brikena Ukperaj (anëtare)*  
*10. Marçela Shehu (anëtare)*  
*11. Yllka Rupa (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këto dy pozicione, dhe përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këto dy pozicione, dhe përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të

drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Hallunaj.

***Dritan Hallunaj***: Faleminderit, Kryetare!

Po parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}.

Me Vendimin nr.535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

Me Vendimin nr.536, datë 17.11.2021, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Me Vendimin nr.537, datë 17.11.2021, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në të tria rastet, afati i kandidimit është përcaktuar “një muaj nga dita e publikimit i vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vendimet e Këshillit si më lart janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 18.11.2021.

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Me vendimin nr. 26, datë 17.01.2022 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimet e datës 17.11.2021, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:...1.Për kandidaten znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;...”.

Më datë 17.01.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të vendimit nr.75/2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i azhurnuar, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 ditëve.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit.

Më datë 24.01.2022, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas vendimit nr.75/2019, kandidatja duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 31 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 24.02.2022, pranë ILDKPKI-së.

Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 10.02.2022, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr.75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

Sipas pikës 9 të vendimeve të Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të vendimit të Këshillit nr.535, datë 17.11.2021, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u

ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Ndërsa në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë janë si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre tre vendimeve, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me shkresën nr. {...} prot., datë 27.01.2022, dhe me shkresën nr. {...} prot., datë 02.02.2022 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten, siç do të përshkruhet më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative si dhe në fushën e të drejtës civile, u kërkua informacion pranë gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, konkretisht në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Korçë, Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjithashtu, për këtë gjyqtare u administrua informacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me shkresën nr. {...} prot. (përmendur më sipër), lidhur me përvojën profesionale si Inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë informacioni i kërkuar është përcjellë me shkresën nr. {...} prot., datë 04.02.2022, dhe nga Gjykata e Apelit Shkodër informacioni i kërkuar është përcjellë me shkresën nr. {...} prot., 02.02.2022 siç do të përshkruhet më poshtë.

Rezultatet e verifikimit paraprak për tre kriteret:

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 136, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”. Ndërkohë, “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet dhe në nenin 47, pika 5, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për tre pozicione të lira, atë në fushën e të drejtës administrative dhe ato të së drejtës civile, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është e njëjtë për të tre kandidimet, pra jo më pak se trembëdhjetë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës administrative për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë

17.11.2021 dhe në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007. Në periudhën tetor 2007 është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ka ushtruar funksionin deri në tetor 2008. Në vijim, në muajin mars të vitit 2009 emërohet gjyqtare pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ka ushtruar funksionin deri në mars të vitit 2013, kohë kur është emëruar si Inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në vitin 2016, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, funksion të cilin e kryen edhe aktualisht.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 05.10.2007 është emëruar gjyqtare dhe caktuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për të kryer stazhin profesional. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 25.03.2009, ajo është emëruar gjyqtare pranë po të njëjtës gjykatë, pra Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendimin nr. {...}, datë 18.03.2013, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar Inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 08.11.2016 është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, funksion të cilin e ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në funksionin e magjistratit është 14 (katërmëdhjetë) vite dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, rezulton të ketë mbi tremëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë, atë të apelit dhe si inspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (magjistrate e komanduar).

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesat për shprehje interesi të kandidates, evidentohet se plotëson kriteret profesionale, pasi ka gjykuar dhe punuar në fushën e të drejtës administrative, penale, familjare dhe civile.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton se:



“Znj. {...} ka kryer stazhin profesional si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në Dekretin nr. 5479, datë 05.10.2007 të Presidentit të Republikës. Më pas, me dekretin nr. 6109, datë 25.03.2009, ajo është emëruar gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Sipas dokumentacionit që disponohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk kemi arritur të gjejmë urdhër të kryetarit të gjykatës, për caktimin e kësaj gjyqtareje në dhoma apo seksione të veçanta, gjatë periudhës që ajo ka kryer stazhin profesional, por rezulton që të ketë gjykuar çështje të ndryshme, si çështje penale ashtu dhe civile, përfshirë civile të përgjithshme, administrative e familjare.

Kurse për periudhën pas emërimit të znj. {...} si gjyqtare pranë kësaj gjykate, detyrë të cilën e ka ushtruar deri më datë 18.03.2013, rezulton të ketë qenë e caktuar si gjyqtare në dhomën/seksionin përkatës, si më poshtë:

- 01.04.2009 – 18.01.2011 Dhoma Civile, seksioni familjar;
- 18.01.2011 – 13.03.2013 Dhoma Penale, seksioni penal për madhorët dhe seksioni i veçantë penal për të miturit.

Bashkëlidhur urdhri nr. {...} prot., datë 01.04.2009 “Shtesë në Urdhrin nr. 2, datë 21.01.2009 “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues””.

Duke pasur parasysh informacionin si më lart, dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, lidhur me kryerjen e stazhit profesional si gjyqtare, përmes rrugës elektronike u kërkua informacion më i detajuar, lidhur me fillimin dhe mbarimin e stazhit pranë kësaj gjykate.

Në përgjigje të komunikimit të datës 18.02.2022, është saktësuar se:

“Në lidhje me saktësimin e informacionit të dërguar për përvojën profesionale informojmë se:

Nga koha e caktimit për të kryer stazhin profesional, datë 05.10.2007, deri në kohën ku është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, datë 25.03.2009, Znj.{...} ka vijuar të ushtrojë funksionin pranë kësaj gjykate, pra gjatë gjithë kësaj periudhe pa ndërprerje. Konfirmimi bazohet në faktin se gjatë gjithë kësaj periudhe rezulton të jenë dhënë vendime nga ana e kësaj gjyqtareje, ...”, etj.

Gjithashtu, sa i përket përvojës së saj në fushën e së drejtës administrative, është e qartë përvoja e saj si inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën mars 2013 – nëntor 2016.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit Shkodër, rezulton se (ndër të tjera):

- Nga data e emërimit 08.11.2016 – 31.12.2016, çështje penale si relatores 23, çështje civile 26, 17 kërkesa penale dhe 5 kërkesa civile;

- Viti 2017, ka 90 çështje si raportore, 73 civile dhe 69 kërkesa penale, dhe civile të tjera 20;

Janë të dhënat për vitet 2018-2021

Sa më sipër, përvoja e kandidatës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pranë Gjykatës së Apelit Shkodër është mbi 5 vjet në total, në fushën e së drejtës civile.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit ku ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore të marra ndaj meje gjatë kryerjes së detyrës apo masa disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton që nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Pa u futur në specifikime për sa i përket këtij kriteri, në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit ku ndër të tjera

“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 10.12.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk jam në asnjë nga situatat e papajtueshmërisë ambientale të përcaktuara sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 8, të

ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Përfundimisht, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procesit të verifikimit të tre kriterëve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Lartë, me aktin protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 08.03.2022, kandidatja {...}, paraqet kërkesë për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas kërkesës ajo thekson: “...duke qenë se gjatë këtyre viteve pune, përvoja ime profesionale dhe përgatitja ka qenë më shumë e orientuar në fushën e së drejtës civile, ku dhe mendoj se mund të jap kontributin tim më të mirë, kërkoj të heq dorë nga kërkesa ime për kandidim në pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë, në fushën administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit.”

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraparak për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, si dhe duke vlerësuar të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja znj. {...} për t’u tërhequr nga kandidimi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ky Komision, më datë 10.03.2022, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale për ngritjen në detyrë, vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare, duke u shprehur:

1.Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës

profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2.Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

3.Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, për shkak të tërheqjes së kandidatës znj. {...}, nga kandidimi.

Ju faleminderit!

Kemi përgatitur edhe projektvendimin përkatës.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin ose kalojmë në votimin e tij.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

3. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

4. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.*
7. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020, për kandidaten znj. {...}. Relator?

*Dritan Hallunaj:* Vijoje të jem unë Kryetare.

Nëse mundem, po vijoj.

Paraqes relacionin për tërheqjen e kandidates, znj. {...}, nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Në të tria këto procedura të ngritjes në detyrë afati i kandidimit është përcaktuar “deri më datë 23.10.2020”. Kandidatja është njoftuar për vendimmarrjen e Këshillit.

Me vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet (ndër të tjera) nr. 392, nr. 395 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke caktuar relator z. Alban Toro.

Më datë 05.11.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit; - për caktimin e relatorit...; pra janë ndjekur të gjitha procedurat të cilat janë të specifikuar në relacion.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraparak për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me vendimin nr. 627, datë 10.12.2020, ka vendosur:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 392, nr. 395, datë 07.10.2020, dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 392, nr. 395, datë 07.10.2020 dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020”.



Ndërkohë, në lidhje me kriteret e pasurisë dhe të figurës, në shkronjën “b”, pika 5, të vendimeve të Këshillit nr.392, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, përcaktohet se: b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi mori në shqyrtim në seancë dëgjimore, më datë 24.06.2021, me Vendimin nr. 407, datë 25.06.2021, ka vendosur:

“1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”, etj.

Vendimi më lart i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

Në përfundim të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidaten znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.525, datë 10.11.2021 ka vendosur:

“1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr.392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr.396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24 të Vendimit nr.70, datë 07.02.2020, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve, me vendimin nr.231, datë 02.06.2021 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr.174, datë 28.05.2020, dhe nr.392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, ka vendosur: Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës,

për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale dhe së drejtës civile, duke caktuar si relator zotin Toska.

Si pasojë e mbarimit të mandatit 3-vjeçar të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Toska, më vendimin nr.25, datë 17.01.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

Ndryshimin e vendimit nr.57, datë 16.02.2021; vendimit nr.231 dhe vendimit nr.390, duke caktuar si relator zotin Dritan Hallunaj.

Më datë 17.01.2022, në rrugë elektronike kandidatja është njoftuar mbi ndryshimin e vendimit dhe caktimin e relatorit të ri, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit.

Brenda afatit kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me këto fakte.

Kandidatja, me shkresën e paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar me nr.1587, datë 15.03.2021, ka shprehur vullnetin e saj për heqjen dorë nga kërkesa për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile pranë Gjykatës së Apelit Durrës, shpallur me vendimin nr.392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedura të cilat ishin në proces.

Në rrethanat e mësipërme, kur kandidatja është në procedurën e përzgjedhjes, u përgatit edhe relacioni bazuar në Vendimin e Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.”

Duke vlerësuar të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja znj. {...} për t’u tërhequr nga kandidimi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke vlerësuar të rregullt procedurën e ndjekur për këtë kandidate deri tani, relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 16.03.2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja znj. {...}, në kërkesën për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të vendimit nr.70, datë 07.02.2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e kësaj

procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për kandidaten, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Është përpiluar edhe projektvendimi përkatës:

“1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr.392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.”

Ky ishte relatimi e nderuar Kryetare.

Nëse kanë anëtarët ndonjë gjë.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Hallunaj!

Do të ftoja kolegët për të votuar, nëse nuk kanë diskutime, lidhur me projekt-aktin.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit për zonjën {...}.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr.392, datë

07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290 datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Marçela Shehu</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>11. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.**
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290 datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek akti i radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290, datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të plotësuar vendet vakante në sistemin gjyqësor në përgjithësi dhe mënyrë të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit me vendimet përkatëse nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290, datë 06.07.2021, nga ana e Këshillit është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Një nga kandidatët ka qenë edhe zoti {...}, për të cilin filluan edhe fazat e ndryshme të procedurave të ngritjes në detyrë dhe përkatësisht, me vendimin nr. 571, datë 20.11.2020, nga ana e Këshillit është

vendosur verifikimi i plotësimi nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020 dhe në Gjykatën e Apelit Durrës (në fushën civile), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 392, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Më tej, me vendimin nr. 334, datë 28.07.2021 “Për Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021”, nga ana e Këshillit është vendosur: Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021.

Më pas, me vendimin nr. 570, datë 07.12.2021, nga ana e Këshillit është vendosur kualifikimi i zotit Pëllumbi dhe vijimi i procedurës së emërimit në Gjykatën Administrative të Apelit për dy pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290 datë 06.07.2021, dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 30 datë 25.01.2021.

Me vendim nr. 58, datë 16.02.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërsa procedura e përzgjedhjes për ngritje në detyrë vijonin, me shkresën protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 28.02.2022, kandidati ka paraqitur një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të cilës ka parashtruar se tërhiqet nga kandidimi për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë kuadër, duke marrë për bazë vullnetin e magjistratit, bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

Në këtë kuadër, pasi është marrë edhe miratimi i Komisionit, ju është dërguar projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira, të shpallura me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira, të shpallura me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione.



2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 181 datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtare)
- 10. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 11. Yllka Rupa*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.**
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 181 datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt–aktin e radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, për kandidatin z. {...}. Edhe për këtë relator është zoti Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Më herët, me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, nga ana e Këshillit është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Një nga kandidatët ka qenë edhe zoti {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe aktualisht i komanduar si gjyqtar i skemës së delegimit në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar nga data 05.11.2020 e në vijim.

Edhe për këtë gjyqtar janë bërë disa veprime procedurale në kuadër të ngritjes në detyrë të tij.

Konkretisht, me vendimin nr. 238, datë 07.07.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 173, nr. 174, nr. 176, nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182, nr. 183, nr. 184, nr. 185, nr. 186, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit, nga ana e Këshillit, me Vendimin nr. 308, datë 10.09.2020, është vendosur verifikimi i plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 173, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Këshilli ka proceduar me vendimin nr. 168, datë 22.04.2021, ku ka vendosur kualifikimin e z. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Tiranë, (në fushën e të drejtës civile), për tre pozicionet e lira, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 173, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020.

Ndërkohë, me vendimin nr.56, datë 16.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur fillimi i procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërsa procedura e përzgjedhjes për ngritje në detyrë vijonte, me shkresën protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 25.02.2022, kandidati ka paraqitur një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të cilës ka parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke marrë për bazë vullnetin e magjistratit si dhe përcaktimet e bëra në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, pasi mori edhe vendimin e Komisionit, relatori ju sugjeron të miratoni projektvendimin bashkëlidhur këtij relacioni, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020 për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë kundërshtime ose sugjerime mbi projekt-aktin, të kalojmë në votim.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020 për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Marçela Shehu</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>11. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**

**3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**

**4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

**5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.**

**7. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidaten znj. {...}. Edhe për këtë kandidate, relator është z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli për të plotësuar vakancat në Gjykatën e Apelit Tiranë, përkatësisht me vendimet nr. 181, nr. 183, datë 28.05.2020 si dhe vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, ku ky Këshill ka proceduar me aktin e hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë për të tre pozicionet në fushën e të drejtës civile. Një nga këto kandidate ka qenë zonja {...}, e cila është gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Durrës.



Me vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, nga ana e Këshillit është vendosur fillimi i procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët që kanë kandiduar, ndër të tjera edhe për dy pozicionet e lira sipas pikave 1 dhe 2 të këtij relacioni, përfshirë edhe për kandidaten znj. {...}.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraparak për znj. Kacerja në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit, nga ana e Këshillit, me Vendimin nr. 279, datë 08.09.2020, është vendosur: Verifikimi i plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Më tej, me vendimin nr. 270, datë 28.06.2021, nga ana e Këshillit është vendosur kualifikimi i kandidates znj. {...} dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181, nr.183, datë 28.05.2020 dhe nr.394, datë 07.10.2020.

Ndërkohë, me vendimin nr. 56, datë 16.02.2021, nga ana e Këshillit është vendosur: Fillimi i procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që procedurat vijonin, nga zonja {...} me kërkesën e datës 04.02.2022 protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., rikonsideroi kandidimet e saj, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke marrë për bazë vullnetin e magjistrates, bazuar edhe në përcaktimet që bën pika 17, Seksioni B, Kreun VI, të vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, pasi u shqyrtua edhe nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relatori ju paraqet projektvendimin, ku ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 181 dhe nr.

183, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit, të kalojmë në procesin e votimit.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185 datë 28.05.2020 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**

**3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**

**4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

**5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.**

**7. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185 datë 28.05.2020 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që edhe ky ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet përkatëse për kandidaten znj. {...}. Fjalën ia jap zonjës Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Gjyqtarja zonja {...}, më herët ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në disa pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, konkretisht për pozicionet e shpallura me vendimet e Këshillit nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, si dhe për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020.

Me cilësinë e relatores kam realizuar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit të zonjës {...} për këto pozicione dhe pas përfundimit të procedurës së plotë të verifikimit që lidhej me të gjitha kriteret, pra pas verifikimit të kriterit të “përvojës profesionale”, të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të “mospasjes

masë disiplinore në fuqi”, pas verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 352, datë 09.09.2021 ka vendosur kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale ku ajo kishte kandiduar.

Pas kualifikimit, zonja {...} u bë një nga kandidatet e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në tre pozicionet e lira ku ajo kishte kandiduar, referuar vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Ndërkohë që Këshilli vijonte me administrimin e dokumentacionit të nevojshëm në funksion të përmbylljes së procedurave të përzgjedhjes sa i përket procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, kandidatja znj. {...}, me datë 15.03.2022 ka depozituar një kërkesë ku ka parashtruar se është tërhequr nga kandidimi për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 184 dhe nr. 185, dhe nr. 396.

Unë do të citoj shkurtimisht kërkesën dhe arsyet e parashtruara nga magjistratja në këtë kërkesë:

“Unë {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, Seksioni “Për të miturit”, ju drejtohem me këtë kërkesë duke shprehur dorëheqjen time të parevokueshme nga kandidimi im në pozicionet e lira të sipërcituara.

Kam filluar punën si gjyqtare në vjeshtën e vitit 2006 dhe prej atëherë e në vazhdim e kam kryer këtë detyrë prej më shumë se 15 vite, pa asnjë ndërprerje.

Kam gjykuar në seksione të ndryshme, në fusha të ndryshme të së drejtës, pranë disa gjykatave.

Më datë 23.11.2021 më ka përfunduar procesi i vlerësimit profesional i kryer nga KLGJ, me vlerësimin "Shkëlqyeshëm".

Me kalimin e një kohe tepër të gjatë, që prej datës 15.06.2020, kur unë kam kandiduar lidhur me këto pozicione të lira, marrë në konsideratë edhe zhvillimin e vijueshëm (ndërkohë) të jetës profesionale, rrjedhimisht interesat, premiset, kërkesat e mia intelektuale i ndjej të ridimensionuara. Kështu ndjej arsye për të reflektuar dhe për të kërkuar zgjedhje të reja më përkuese dhe rishtazi më të afërta me kërkesat dhe prioritetet e mia aktuale në aspektin profesional.

Në vazhdim, do të bëj me dije zyrtarisht kërkesat dhe aplikimet e mia përkatëse, të cilat përkojnë dhe zhvillojnë interesin tim intelektual dhe profesional në vijueshmëri.”

Pas paraqitjes së kërkesës për tërheqje nga kandidimet e saj të zonjës {...}, me cilësinë e relatores, kam përgatitur relacionin përkatës, bazuar në pikën në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të vendimit të Këshillit nr. 70/2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare”.

Duke vlerësuar se vullneti i kandidatës tashmë është pasqyruar në mënyrë të qartë, relacioni dhe propozimi im i është paraqitur Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në datën 23.03.2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 184, nr. 185 dhe nr. 396, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Bashkëlidhur është edhe projektvendimi i cili i paraqitet për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

***Ilir Rusi:*** Pro.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Dakord.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, si dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.03.2022)*

**Pika 9 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, relator z. Klodian Kurushi.<sup>2</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:50 dhe mbaroi në orën 12:35.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

<sup>2</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është shtesë në rendin e ditës dhe është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës::

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Valbona Paja, Përfaqësuese e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

Pika 9 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, relator z. Klodian Kurushi.

Çështja shtesë për trajtim në rendin e ditës, si çështje e fundit, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, konkretisht për një kërkesë të karakterit “urgjent” të ardhur nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (karakter “tepër urgjent”, lexohen të dhënat e çështjes së kërkuar referuar në tabelën në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z.Valbon Çekrezi.

Përpara hedhjes së shortit merr fjalën **zonja Ukperaj** për të drejtuar një pyetje relatorit: Janë kërkuar gjyqtarë vetëm për shuarjen e masës apo për të gjykuar çështjen? Sepse normalisht, gjykata që gjykon shuarjen e masës është gjykata që shqyrton çështjen. Nëse kjo çështje është në shqyrtim, duhet ta shqyrtojnë gjyqtarët që e gjykojnë çështjen. Në rast se çështja nuk është në shqyrtim, ne duhet të caktojmë gjyqtarë për të shqyrtuar çështjen, të cilët automatikisht do gjykojnë çështjen për shuarje mase.

Lidhur sa më lart, **zoti Kurushi** ndër të tjera sqaron se në kërkesën e paraqitur nga kryetari i gjykatës së apelit rezulton që vetëm një gjyqtar në gjykatën e apelit është i mundur për të vijuar më tej shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore, por për shkak të karakterit “urgjent”, do duhet dy gjyqtarë të tjerë. Duke qenë se bëhet fjalë për çështjen gjyqësore që gjykohet në apel, të gjithë gjyqtarët e gjykatës së apelit janë të konsumuar, kështu që përtej kërkesës urgjente për shqyrtimin e çështjes, këta gjyqtarë do të duhet të vijojnë gjykimin edhe për themelin e mëtejshëm të kësaj çështjeje.

**Zonja Ukperaj** sqaron se ndërhyrja u bë, që nga ana e Këshillit, të specifikohet që gjyqtarët do shqyrtojnë jo vetëm shuarjen, por edhe çështjen e themelit. Pra që nuk do duhet të caktohet një trup tjetër gjykues.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë më rezerva apo kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Irida Kacerja.

Sugjerimet e bëra më sipër do të jenë pjesë e relacionit përfundimtar dhe njoftimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe apelit Durrës.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Pika 9 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**